



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	5428/26
Nr. i fq. / Br. st.	-5-
Data: / Datum:	04.02.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-24/26 04.02.2026

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA INAUGURUESE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 12 DHJETOR 2025

Mbledhja është mbajtur në sallën e Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina pjesa solemne ndërsa pjesa zgjedhore e mbledhjes është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:00.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Pllumb Maliqi Ramadan Parduzi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i zgjedhur i komunës, z.Ferit Idrizi, komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri, përfaqësuesi i Akademisë Policore në Vushtrri, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile, mysafirë dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Isak Uka – anëtar i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Isak Uka anëtar i kuvendit-në hapej të mbledhjes inauguruese deklaroi: duke u bazuar në dispozitat e nenit 42 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sipas detyrës zyrtare, si anëtar i më i moshuar i këtij kuvendi të dalë nga zgjedhjet e datës 12 tetor 2025, kam obligim ligjor të udhëheq këtë mbledhje inauguruese. Më tej shtoj është nder i veçantë për mua, si anëtar i më i moshuar i këtij Kuvendi, të hap sot këtë mbledhje inaugurues, e cila shënon fillimin e një kapitulli të ri të përfaqësimit demokratik dhe shërbimit ndaj qytetarëve tanë. Momente të tilla na kujtojnë përgjegjësinë që mbartim dhe peshën e mandatit që na është besuar. Duke ju falënderuar për vëmendjen, shpall të hapur punimet e kësaj mbledhjeje inauguruese të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Pas votimit Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mënyrë "unanime" aprovoi këtë:

REND DITE

1. Formimi i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë- verifikimi i mandateve nga komisioni në fjalë;
 2. Dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe e kryetarit të komunës (pjesa solemne) dhe
 3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë (pjesa zgjedhore).
-
1. Formimi i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë- verifikimi i mandateve nga komisioni në fjalë;

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve nga radhët e PDK-së znj. Vlerë Tahiri.

Mek Selaci anëtar i kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit nga radhët e LVV-së znj. Gresa Muli.

Berat Sadiku anëtar i kuvendit - propozoi që anëtar i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit nga radhët e LDK-së z. Ramadan Parduzi.

Pas votimit, kuvendi në mënyrë unanime miratoi propozimet për themelimin e komisionit për verifikimin e mandateve të kuvendit në këtë përzierje:

Vlerë Tahiri nga radhët e PDK-së;

Gresa Muli nga radhët e LVV dhe

Ramadan Parduzi nga radhët e LDK-së.

Komisioni i sipërcekur bëri verifikimin e mandateve të kuvendit, duke lexuar emrat e secilit anëtar të zgjedhur të kuvendit.

2. Dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit dhe e kryetarit të komunës (pjesa solemne);

Në vazhdim të mbledhjes anëtarët e kuvendit dhanë betimin solemn, duke u bërë anëtarë të kuvendit me të drejta të plota.

Gjithashtu betimin solemn para kuvendit e dha edhe kryetari i zgjedhur i Komunës së Vushtrrisë z. Ferit Idrizi.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë - pasi dha betimin solemn si kryetar i komunës, iu drejtua kuvendit me një fjalim përshëndetës, ku së pari falënderoi qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për besimin e dhënë që të udhëheqë komunën, pasi siç deklaroi ata qytetarët besuan në vizionin e tij, në përgatitjen profesionale, sinqeritetin dhe paanësinë e tij. Më tej ai shtoi se është nderë dhe privilegj që për herë të dytë të zgjidhet kryetar i Komunës së Vushtrrisë, dhe vlerësoi se ky besim e obligonë edhe më shumë që të punojë me përkushtim, transparencë, të vazhdon të jetë kryetar i të gjithë qytetarëve pa dallim. Detyra e tij është që të siguroj që çdo hapë që ndërmerr të jetë në përputhje me ligjin dhe në interes të qytetarëve. Të gjitha vendimet që do të marrë do të jenë transparente, që janë efikase dhe ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Gjatë këtij mandati do të merren vendime që do të vazhdojnë projektet në transformimin e jetës në qytet dhe fshatra, ta modernizojmë administratën, ta reformojmë arsimin dhe shëndetësinë, infrastrukturën dhe ekonominë lokale.

Po ashtu do të punojmë për më shumë rend dhe ligj, shërbime më të shpejta për qytetarët, një komunë që i respekton dhe i dëgjon të gjithë. Edhe njëherë i falënderoj të gjithë qytetarët për besimin e dhënë, falënderoj anëtarët e kuvendit për bashkëpunimin e deritashëm dhe pret bashkëpunim edhe më të frytshëm me anëtarët e sapo zgjedhur në këtë legjislaturë, duke lënë interesat partiake me një anë dhe duke vendosur në qendër interesat e qytetarëve. Ai siguroj se dera e tij e administratës së komunës do të jetë e hapur dhe në shërbim të qytetarëve pa dallim. Bashkë do të punojmë dhe bashkë do ta qojmë përpara komunën e Vushtrrisë. Qoftë ky mandat i mbarë për të gjithë, i suksesshëm dhe me rezultate konkrete për Vushtrrinë tonë të dashur! Zoti ju dhashtë shëndet dhe mbarësi në familjet e juaja faleminderit për vëmendjen!

3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë (pjesa zgjedhore).

Pas konsultimeve me grupet politike të përfaqësuara në kuvend, kryesuesi i mbledhjes së kuvendit konform Rregullores të punës së kuvendit, vendosi që kuvendi t'i zhvillojë punimet pa prezencën e publikut, për shkak të numrit të madh të qytetarëve dhe vështirësimit të zhvillimit të punimeve të mbledhjes punimet vazhduan në sallën e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Në vazhdim të mbledhjes në pjesën zgjedhore, kryesuesi i mbledhjes konstatoi se në sallë janë të pranishëm 23 anëtar të kuvendit (mungojnë 8 anëtarë nga grupi kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje), kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit propozoi për anëtar të komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë z. Kushtrim Hyseni nga radhët e PDK-së.

Grupi kuvendar i LVV-së nuk kishe propozim për komision pasi ata mungon në sallën e kuvendit.

Grupi kuvendar i LDK-së nuk kishe propozim për komision pasi ata refuzuan të japin një emër për atë komision.

Diellza Pllana, anëtare e kuvendit- në emër të Nismës Socialdemokrate propozoi për anëtar të komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë z. Kushtrim Veseli.

Nga aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, për anëtar të komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë u propozua z. Mensur Kastrati.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me 17 vota "për" asnjë "kundër" dhe asnjë "abstenim" aprovoi formimin e komisionit për verifikimin e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

**Kushtrim Hyseni, nga radhët e PDK-së;
Kushtrim Veseli nga radhët e Nismës Socialdemokrate dhe
Mensur Kastrati nga radhët e AAK-së**

Pastaj u hap debati për paraqitjen e propozimeve për kandidat për kryesues të kuvendit:

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar PDK, propozoi znj. Melihate Basholli-Latifi si kandidate për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë. Ai vlerësoi se kandidatja në fjalë është një grua intelektuale me përvojë të gjatë në fushën e arsimit, disa mandatet ka shërbyer si anëtare e kuvendit, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe po ashtu mandatin e kaluar ka ushtuar pozitën e kryesuese së kuvendit andaj ajo është kredibile dhe do ti bëj nder kuvendit udhëheqja nga ana e saj.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- deklaroi se më që nuk kemi pasur ndonjë diskutim për bashkëpunim në zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, atëherë grupi kuvendar i LDK-së nuk ka propozim për kandidat për kryesues të kuvendit dhe rrjedhimisht nuk do të marr pjesë në votim.

Grupet tjera kuvendar, nuk dhanë propozime për kandidatë për kryesues/se të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Pas zhvillimit të votimit të fshehtë, Komisioni për verifikimin e procesit të votimit dhe numërimit të votave konstatoj se me 17 vota “për” asnjë “kundër”, dhe asnjë “abstenim” në bazë të legjislacionit në fuqi rezultoi se znj. Melihate Basholli-Latifi u zgjedhë kryesuese e kuvendit, në ç’ rast u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim znj. Melihate Basholli-Latifi, anëtare e KK-së zgjedhet Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
2. Mandati i të lartpërmendurës në cilësinë e kryesueses të kuvendit të komunës përfundon me rastin e përfundimit të mandatit të anëtarëve të KK-së.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Sekretaria e Kuvendit dhe Menaxheri i Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në kuvendin e komunës dhe pas nënshkrimit nga kryesuesi (anëtar i më i vjetër) i mbledhjes së kuvendit.

Melihate Basholli -Latifi, kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë – deklaroi:

I nderuari kryetar i komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi,

Të nderuar kuvendarë të kuvendit të komunës,

Të nderuar përfaqësues të MAPL-së,

Përfaqësues të OSCE-së të KFOR-it,

Përfaqësues të shoqërisë civile,

Përfaqësues të mediave,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar të pranishëm, mirë se keni ardhë në seancën e parë të kësaj legjislature. Shumë të respektuar qytetarë të komunës së Vushtrrisë, Me lejoni t’ju falënderoj për besimin dhe përkrahjen tuaj të vazhdueshme në rrugëtimin tim politik. Ky besim, i manifestuar sot edhe përmes votës së anëtarëve të Kuvendit, përkon edhe me një përgjegjësi të lartë institucionale, të cilën e pranoj me përgjegjësi dhe përkushtim maksimal. Shpreh falënderim dhe vlerësim të veçantë për kryetarin e komunës se bashku me subjektin tim politik, të cilët më kanë nominuar për detyrën e Kryesueses së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë. Falënderoj, me këtë rast, edhe të gjithë kuvendarët që më dhanë mbështetjen e tyre në këtë seancë konstituive. Ju siguroj se ushtrimin e këtij funksioni do ta realizoj me integritet të plotë, me profesionalizëm dhe me paanshmëri, duke respektuar me përpikëri të gjitha aktet ligjore dhe rregulloret që rregullojnë punën e Kuvendit dhe të institucioneve komunale. Prioriteti ynë i përbashkët do të jetë zhvillimi i politikave dhe vendimmarrjet që reflektojnë mirëqenie më të mirë të të gjithë qytetarëve tanë, pa dallim. Në bashkëpunim të ngushtë me Kryetarin e Komunës dhe me

ekzekutivin komunal, e veçanërisht me të gjithë ju, të nderuar kuvendarë, do të vazhdojmë të angazhohemi për avancimin e mirëqenies së komunitetit në të gjitha fushat e jetës publike: nga infrastruktura dhe arsimi, te shëndetësia, ekonomia lokale, zhvillimi social dhe jo vetëm. Me përgjegjësi institucionale dhe me vullnet të përbashkët, jam e bindur se do të arrijmë rezultate të dukshme dhe do të forcojmë besimin e qytetarëve në punën tonë.


Bashkë na priftë e mbara në këtë mandat të ri!

Mbledhja përfundoi në ora 11:45.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Isak Uka


Anëtar i Kuvendit

